

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT
PËR MBROJTJE SOCIALE

Neni 1

Në Ligjin për mbrojtje sociale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 104/19), pas nenit 29 shtohet nen i ri 29-a, si vijon:

"Neni 29-a

Të drejtën e ndihmës së garantuar minimale mund ta realizojë edhe ekonomia familjare e cila është e pasiguar materialisht por ka në pronësi pronë dhe të drejta pronësore nga të cilat mund të mbahet, në rast kur anëtari i ekonomisë familjare, pronar i pronës lidh marrëveshje për mbajtje gjatë gjithë jetës me qendrën për punë sociale.

Lartësinë e të drejtës së ndihmës së garantuar minimale nga paragrafi 1 i këtij neni, e përcakton qendra për punë sociale në bashkëpunim me shfrytëzuesin varësisht nga vlera e pronës që është lëndë e marrëveshjes për mbajtje të përvetshme, e pas pëlqimit paraprak të Ministrisë."

Neni 2

Në nenin 55 paragrafi 2 ndryshohet si vijon:

"Lartësia e kompensimit të rrogës nga paragrafi 1 i këtij neni, është 50% nga neto rroga mesatare për orar të plotë të punës të prindit të paguar në vitin paraprak, përkatësisht 100% nga rroga neto mesatare për orar të shkurtuar të punës të paguar në vitin paraprak, por më së shumti deri në 50% të neto rrogës mesatare në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin paraprak, të publikuar nga Enti Shtetëror i Statistikës."

Pas paragrafit 2 shtohet paragraf i ri 3, si vijon:

"Me përjashtim të paragrafit 2 të këtij neni, për prind i cili është punësuar dhe ka realizuar të drejtë për orar të shkurtuar të punës gjatë vitit rrjedhës, lartësia e kompensimit të rrogës është 100% nga neto rroga mesatare për orar të shkurtuar të punës të paguar në vitin rrjedhës, por më së shumti deri në 50% të neto rrogës mesatare në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin paraprak, të publikuar nga Enti Shtetëror i Statistikës."

Në paragrafin 3 i cili bëhet paragraf 4, fjalët: "paragrafi 2" zëvendësohen me fjalët: "paragrafët 2 dhe 3".

Neni 3

Në nenin 187 paragrafi 1 fjalët: "të punësuarit" zëvendësohen me fjalët: "punëtorët profesionalë".

Paragrafi 2 shlyhet.

Neni 4

Në nenin 201 pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri 2, si vijon:

"Vlera e pikës për përllogaritje të rrogave të dhënësve të shërbimeve publike dhe drejtorit të institucionit publik për mbrojtje sociale të themeluara nga komuna, qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit, përcaktohet çdo vit me vendim të themeluesit, në kuadër të buxhetit të paraparë dhe në bazë të numrit të përgjithshëm të dhënësve të shërbimeve publike të sistemuar nëpër nivelet adekuate për vitin rrjedhës me ç'rast vlera e pikës nuk mund të jetë më e lartë se vlera e pikës nga paragrafi 1 i këtij neni."

Neni 5

Në nenin 205 paragrafi 1 alineja 7 ndryshohet si vijon:
"-shpenzime për varrim në rast të vdekjes së ofruesit të shërbimit publik ose anëtarit të familjes së tij më të ngushtë (prind me të cilin ka jetuar në ekonomi të njëjtë familjare,

bashkëshort dhe fëmijë të lindur në martesë ose jashtë martese, të birësuar, fëmijë të adoptuar dhe fëmijë të marrë në mbajtje)."

Neni 6

Në nenin 212 paragrafi 18 pas fjalëve: "shkallë të dytë" pika zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: "në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të vendimit për zgjedhje."

Neni 7

Në nenin 298 paragrafi 1 fjalët: "dhe fëmijë" zëvendësohen me fjalën: "person".

Në paragrafin 2 pas fjalës: "mbajnë" vendoset presje dhe shtohen fjalët: "përveç nëse anëtari i familjes i cili ka obligim ligjor për mbajtje, e shfrytëzon të drejtën e ndihmës së garantuar minimale, në pajtim me ligjin."

Neni 8

Shfrytëzuesi i cili me aktvendim e ka realizuar të drejtën për ndihmë të përvetshme me para në bazë të marrëveshjes për mbajtje të përvetshme të lidhur ndërmjet shfrytëzuesit dhe qendrës, në pajtim me dispozitat që kanë qenë në fuqi para miratimit të Ligjit për mbrojtje sociale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 104/19) kalohet në të drejtën e ndihmës së garantuar minimale në lartësi të përcaktuar me marrëveshjen për mbajtje të përvetshme dhe aktvendimin e qendrës.

Neni 9

Të punësuarit ofruet të shërbimeve publike të cilët në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk kanë shkallë përkatëse të arsimit edhe më tutje mund ta ushtrorjnë punën në vendin e punës ku janë gjendur me hyrjen në fuqi të Ligjit për mbrojtje sociale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 104/19).

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

2166.

Врз основа на членот 75, ставови 1 и 2 од Уставот на Република Северна Македонија, претседателот на Република Северна Македонија и претседателот на Собранието на Република Северна Македонија издаваат

У К А З

ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ЗАШТИТА НА ДЕЦАТА

Се прогласува Законот за изменување и дополнување на Законот за заштита на децата, што Собранието на Република Северна Македонија го донесе на седницата одржана на 10 јули 2019 година.

Бр. 08-4017/1
10 јули 2019 година
Скопје

Претседател на Република
Северна Македонија,
Ство Пендаровски, с.р.

Претседател
на Собранието на Република
Северна Македонија,
м-р **Talat Xhaferi, с.р.**